



## ANALIZË E SHKURTËR

Nr.3/14– maj 2015

Ky projekt është përkrahur nga Konrad Adenauer Stiftung



Konrad  
Adenauer  
Stiftung

**Politikëbërja dhe Vendimarrja në Partitë Politike të  
Kosovës: Gratë, Rinia dhe Komunitetet Etnike**

Përmbajtja dhe pikëpamjet të shprehura në këtë botim janë të KIPRED-it, dhe nuk mund të merren si pikëpamje të donatorit.

Autor: Lulzim Peci

Redaktor: Mentor agani

Copyright © 2015, KIPRED. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk bën të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem rikthyes, apo të bartet, në çfarëdo qoftë forme dhe me çfarëdo qoftë pajisjesh, elektronike, mekanike, fotokopjuese, regjistruese, apo të tjera, pa lejen paraprake me shkrim nga botuesi. Luteni të kontaktoni: [info@kipred.org](mailto:info@kipred.org) apo: +381 38 227 778.

Botuar nga:



Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave

Rr. Rexhep Mala, Nr. 5A

10 000 Prishtinë, Kosovë

Telefoni dhe faksi: +381 38 227 778

[www.kipred.org](http://www.kipred.org)

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky punim analizon vendim-marrjen dhe politikë-bërjen e partive politike për çështjet e grave, rinisë dhe të komuniteteve etnike, që kanë grupe parlamentare në Kuvendin e Kosovës, domethënë në Partinë Demokratike të Kosovës (PDK), Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK), Levizjen VETËVENDOSJE!, Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Nismën për Kosovën (NISMA). Rregullimi i këtyre çështjeve nga Lista Serbe, që po ashtu ka grup parlamentar në Kuvendin e Kosovës, nuk është trajtuar në këtë punim, meqë ky grupim politik nuk e ka statusin e partisë politike, por të iniciativës qytetare. Të dhënat për këtë hulumtim janë marrë nga statutet dhe programet partiake, nga programet zgjedhore, si dhe nga intervistat me anëtarë të kryesive të këtyre partive politike.

Rezultatet e hulumtimit tregojnë që fuqizimi i grave dhe rinisë në vendim-marrjen e partive politike të Kosovës varet nga vullneti i kryetarëve të partive, që e kanë të drejtën statutore për të propozuar përbërjen e plotë apo të pjesëshme të kryesive të partive të tyre. Në kryesitë e partive politike rinia është e përfaqësuar simbolikisht, ndërkaq përfaqësimi i grave ndryshon nga 11% (NISMA) deri në 21% (LDK).

Partitë politike të Kosovës nuk kanë sistem të ndërtuar të politikë-bërjes partiake për rininë dhe gratë, megjithë faktin që kanë organizime brendapartiake për këto kategori shoqërore (pos LVV-së, që e ka vetëm sekretariatit për çështje gjinore). Po ashtu, rinia dhe gratë janë trajtuar në mënyrë shumë të vobektë, si në programet partiake ashtu edhe në ato zgjedhoret. Është një fakt shqetësues ai që përfaqësimi në lidhshpirtin e partive politike, dhe posaçërisht ai i grave, nuk është përkthyer proporcionalisht edhe në politikë-bërje, dhe kjo e vë në dukje shpërputhjen e përfaqësimit vendim-marrës në raport me kapacitetin e politikë-bërjes brenda partiake.

Politikë-bërja partiake për komunitetet etnike është sporadike dhe reaktive, dhe kjo në praktikë trajtohet më tepër si politikë qeveritare dhe legjislative, dhe jo si politikë brenda-partike.

**REKOMANDIME:**

- Partitë politike të Kosovës duhet të ndërtojnë sisteme funksionale të politikë-bërjes dhe ta bëjnë ndërlidhjen e tyre me përfaqësimin vendim-marrës të grave dhe të rinisë brenda strukturave të tyre.
- Liderët e partive politike duhet të kenë parasysh rritjen e përfaqësimit të grave, dhe posaçërisht të rinisë në udhëheqësitë partiake.
- Partitë politike duhet të ndërtojnë brenda strukturave të tyre sektorë të politikë-bërjes për komunitetet etnike, me qëllim të ndërtimit të ekspertizës në këtë fushë, dhe të formulojnë politika proaktive për adresimin e nevojave zhvillimore të komuniteteve.

## I. RREGULLIMI STATUTOR I PJESËMARRJES SË GRAVE DHE RINISË NË VENDIM-MARRJEN PARTIAKE.

Në këtë seksion është analizuar rregullimi statutor dhe gjendja faktike e përfaqësimit të grave dhe rinisë në vendim-marrjen partiake, me qëllim të ekzaminimit të kapaciteteve të tyre për të ndikuar në politikë-bërjen brenda subjekteve politike, për sa i përket çështjeve që janë në interesin e tyre të drejtpërdrejtë.

***Partia Demokratike e Kosovës (PDK)***, përmes Statutit të saj përcakton taksativisht organizimin brendapartiak të grave dhe të rinisë përmes Gruas Demokratike (GD) dhe Rinisë Demokratike (RD).<sup>1</sup> Roli normativ i këtyre organizatave është promovimi i ideve, vlerave dhe i vizionit të PDK-së në grupet shoqërore në të cilat veprojnë,<sup>2</sup> ndërkaq, puna e tyre rregullohet me rregullore të veçanta që miratohen nga Kryesia e partisë<sup>3</sup>.

Në aspektin e përfaqësimit në organet vendim-marrëse të partisë në nivelin lokal, statuti i partisë parasheh anëtarësinë ex-officio në Kryesinë e Degëve të PDK-së të kryetarëve të Degëve të RD-së dhe të GD-së.<sup>4</sup> Të njëjtin përfaqësim në Kryesinë Qendrore të PDK-së e gëzojnë edhe Kryetari i RD-së dhe Kryetarja e GD-së. Po ashtu, anëtarët e Kryesive Qendrore të RD-së dhe të GD-së janë edhe anëtarë të Konventës së Përgjithshme të PDK-së.<sup>5</sup> Mirëpo, Statuti i PDK-së nuk e parasheh përfaqësimin e RD-së dhe të GD-së, në Këshillin Drejtues, që është edhe organi më i lartë vendim-marrës në mes të dy konventave të partisë. Megjithatë, në këtë organ të PDK-së, gratë janë të përfaqësuara me 28.5%, përkatësisht, me 33 nga 110 anëtarët e Këshillit Drejtues<sup>6</sup>.

Mirëpo, në fuqizimin e mëtutjeshëm të përfaqësimit të grave dhe të rinisë rolin vendimtar e ka Kryetari i PDK-së, që në bazë të Statutit e ka të drejtën e propozimit të zëvendës-kryetarit, të nënkryetarëve dhe të Sekretarit të Përgjithshëm, dhe anëtarët e Kryesisë Qendrore,<sup>7</sup> që zgjedhen nga Këshilli Drejtues i partisë<sup>8</sup>. Megjithatë, në Kryesinë Qendrore 30-anëtarëshe të PDK-së, të propozuar nga Kryetari i saj, përqindja e përfaqësimit të femrave është 16.6%, përkatësisht, 5 anëtarë të Kryesisë, ndërkaq, rinia është e përfaqësuar nga z. Memli Krasniqi, nënkryetar për çështje

---

<sup>1</sup> Statuti i PDK-së (2013), Neni 55

<sup>2</sup> Ibid., Neni 57

<sup>3</sup> Ibid.

<sup>4</sup> Ibid., Neni 24

<sup>5</sup> Ibid., Neni 31

<sup>6</sup> Këshilli Drejtues i PDK-së, <http://pdk.info/sq-al/udh%C3%ABheqja/keshillidrejtues.aspx>

<sup>7</sup> Statuti i PDK-së, Neni 37.

<sup>8</sup> Ibid, Neni 42.

organizative dhe i rinisë. Z. Krasniqi ka qenë më parë Kryetar i RD, dhe këtë funksion e ushtron edhe më tutje, pavarësisht nga ajo që e ka tejkaluar moshën 30-vjeçare<sup>9</sup>.

***Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)***, përmes Statutit të saj specifikon organizimin brenda partiak të grave dhe të rinisë përmes Forumit të Gruas (FGLDK), përkatësisht, Forumit të Rinisë (FRLDK)<sup>10</sup>. Roli normativ i këtyre organizatave është afirmimi dhe realizimi i politikave të LDK-së në fushat në të cilat veprojnë, dhe këto u ndihmojnë organeve të partisë për krijimin e politikave të qëndrueshme. Organizimi dhe zgjedhjet në FGLDK dhe FRLDK rregullohen me rregullore të veçanta që aprovohen nga Këshilli i Përgjithshëm i partisë,<sup>11</sup> ndërkaq, mosha e angazhimit të të rinjëve brenda FRLDK është e kufizuar në 26 vjet.<sup>12</sup>

Në aspektin e përfaqësimit në organet vendim-marrëse të partisë në nivelin lokal, Statuti i LDK-së e përcakton anëtarësinë ex-officio të kryetarëve të Degëve të FRLDK-së dhe FGLDK-së në Kryesitë e Degëve të saj<sup>13</sup>. Në Kryesinë Qendrore të LDK-së është i paraparë përfaqësimi i njëjtë për Kryetarin e FRLDK-së dhe Kryetaren e FGLDK-së<sup>14</sup>. Për sa i përket përfaqësimit të grave dhe të rinisë në Kuvendin e Përgjithshëm të LDK-së, Statuti i LDK-së me rastin e zgjedhjes së delegatëve nga degët e saj kërkon sigurimin e përfaqësimit të rinisë dhe të grave, mirëpo nuk e përcakton përqindjen apo numrin e përfaqësuesve. Ndërkaq, sa i përket përfaqësimit në Këshillin e Përgjithshëm të partisë, Statuti parasheh marrjen pjesë në mbledhjet e tij të Kryetarëve të FRLDK dhe të FGLDK, por pa të drejtë vote, pos nëse ata nuk janë anëtarë të zgjedhur të këtij organi partiak. Megjithatë, edhe përkundrejt faktit të mungesës së kuotave, gratë janë të përfaqësuara në Këshillin e Përgjithshëm me 20%, përkatësisht me 22 nga 110 anëtarët e tij<sup>15</sup>.

Meqenëse Statuti i LDK-së i jep mandat Kryetarit të saj propozimin e nënkryetarëve, të sekretarit të përgjithshëm dhe të anëtarëve të Kryesisë, të cilët zgjedhen nga Këshilli i Përgjithshëm<sup>16</sup>, fuqizimi i përfaqësimit dhe i rolit të rinisë dhe grave në ekzekutivin e partisë rrjedhimisht varet nga vullneti i tij. Në Kryesinë 19 anëtarëshe të LDK-së, me propozim të Kryetarit Isa Mustafa, gratë janë të përfaqësuara me 21%, përkatësisht me 5 anëtare, përfshirë këtu edhe nënkryetaren, znj. Teuta Sahatqia, ndërkaq, rinia është e përfaqësuar vetëm me kryetarin e FRLDK, z. Armend Ibrahimin.

---

<sup>9</sup> Memli Krasniqi ka lindur ne vitin 1980

<sup>10</sup> Statuti i LDK-së (mars 2013), Neni 38

<sup>11</sup> Ibid.

<sup>12</sup> Statuti i LDK-se, Neni 45.3.

<sup>13</sup> Ibid., Neni 24

<sup>14</sup> Ibid, Neni 29.3

<sup>15</sup> Keshilli i Pergjithshem i LDK-se, <http://www.ldk-ks.eu/Al/organizimi/keshilli-pergjithshem/>

<sup>16</sup> Statuti i LDK-se, Neni 24.1.

**Lëvizja Vetë-Vendosje (LVV)**, për dallim nga PDK dhe LDK, brenda strukturës së vet kjo nuk ka organizatë të rinisë dhe të grave. Mirëpo, në nivelin e qendrave dhe në atë nacional të LVV-së janë të parapara sekretariatet e gruas aktiviste, që e kanë statusin e sekretariateve statutore, që janë pjesë e sekretariatit të qendrave, si dhe të atij të përgjithshëm<sup>17</sup>. Sekretariatet e qendrave dhe ai i përgjithshmi, janë organe ekzekutive të kryesive dhe të këshillave të niveleve përkatëse të organizimit të LVV-së. Mirëpo, në aspektin faktik, gratë janë të përfaqësuara me 20% në Kryesinë e LVV-së, përkatësisht me 3 nga 15 anëtarët e saj, me 23.60% në Këshillin e Përgjithshëm, dhe me 36.6% në Sekretariatit e Përgjithshëm<sup>18</sup>. LVV brenda vetes nuk ka organizim të posaçëm për rininë<sup>19</sup>.

**Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)** është në proces të brendshëm zgjedhor, dhe në marsin e këtij viti e ka aprovuar statutin e ri të partisë në bazë të të cilit do të udhëhiqet në periudhën vijuese. Ky Statut i ri i AAK-së, si formë të organizimit partiak të grave dhe të rinjve i përcakton Aleancën e Gruas të Kosovës (AGK) dhe Aleancën e të Rinjve të Kosovës (ARK),<sup>20</sup> të cilat kanë strukturat e veta të mëvetësishme dhe kanë të drejtë të nxjerrin aktet e veta, që duhet të jenë në kohezion me Statutin e partisë<sup>21</sup>. Po ashtu, Statuti moshën e anëtarëve të ARK-së e kufizon në 30 vjet.<sup>22</sup>

Përfaqësimi i AGK dhe ARK në organet e partisë fillon nga niveli i nëndegëve, në të cilin është paraparë që të dyja këto organizime në kuvendet e veta të zgjedhin, në bazë të kuotave të përcaktuara me rregulloren e zgjedhjeve partiake, nga 10 delegatë/e për kuvendet e degëve të partisë<sup>23</sup>. Po ashtu, Statuti parasheh që në kuvendet e AGK dhe të ARK të zgjedhen nga 20 delegatë për Kuvendin Qendror të AAK-së.<sup>24</sup> AAK është e vetmja parti në Kosovë që në Statut e ka të paraparë edhe kuotën për gra dhe të rinj në Këshillin Drejtues të saj, ku AGK dhe ARK përfaqësohen me nga 5 anëtarë, ndërkaq, në Këshillet e Degëve këto përfaqësohen me nga 3 anëtarë.<sup>25</sup> Mirëpo, edhe në përbërjen e tanishme të Këshillit Drejtues në dorëheqje të AAK-së, kjo kuotë tejkalohet bindshëm në përfaqësimin e grave, që është 25%, përkatësisht 25 nga 100 anëtarët e tij<sup>26</sup>.

---

<sup>17</sup> Statuti i Levizjes VETEVENDOSE!, Neni 59 dhe Neni 77

<sup>18</sup> Interviste me z. Boiken Abazi, Sekretar per Marredhenie me Jashte i LVV, Mars 2015

<sup>19</sup> *Ibid.*

<sup>20</sup> Statuti i AAK (2015), Neni 4

<sup>21</sup> *Ibid*, Neni 33 dhe 34

<sup>22</sup> *Ibid*. Neni 34.

<sup>23</sup> *Ibid*. Neni 15.

<sup>24</sup> *Ibid*.

<sup>25</sup> *Ibid*, Neni 18.

<sup>26</sup> Shih Listen e Keshillit Drejtues te AAK-së.

Në çdo nivel të organizimit të AAK-së, kryetarët e AGK dhe të ARK janë anëtarë ex-officio të kryesive përkatëse të partisë<sup>27</sup>. Megjithatë, për dallim prej partive të tjera, që nuk i kanë të përcaktuara kuotat, dhe fuqizimi i përfaqësimit të grave varet nga kryetari i partisë, Statuti i AAK-së parasheh përfshirjen e grave në kryesitë e degëve dhe ato të partisë me të paktën 30%<sup>28</sup>. Për sa i përket gjendjes faktike të përfaqësimit, në Kryesinë e tanishme në dorëheqje të AAK-së, gratë janë të përfaqësuara me 20%, dhe atë 11 nga 51 anëtarët e saj<sup>29</sup>. Mirëpo, Statuti i ri i AAK-së nuk parasheh kuota të përfaqësimit për anëtarët e saj të moshës rinore.

**Nisma për Kosovën (NISMA)**, si parti e re, ende nuk ka ende statut të partisë, dhe punon me një rregullore të përkohshme<sup>30</sup>. Statuti i NISMES planifikohet të aprovohet në Konventën e Përgjithshme, që pritet të mbahet gjatë këtij viti. Në përbërjen e tanishme të Kryesisë së NISMES, gratë janë të përfaqësuara me 11%, përkatësisht me dy nga 17 anëtarët e saj.

**Konkludim:** Të dhënat dhe faktet e mësipërme tregojnë se megjithë faktin që partitë politike i kanë të rregulluara në aspektin statutor organizimin e grave dhe të rinisë brenda tyre (me përjashtim të Lëvizjes VETËVENDOSJE!, që ka vetëm sekretariat për çështje gjinore dhe për rini nuk ka fare), fuqizimi i këtyre dy kategorive në vendim-marjen partiake varet në një masë të madhe nga vullnetet e kryetarëve të partive, që e kanë të drejtën statutore për të propozuar përbërjen e plotë apo të pjesshme të kryesive të partive.

Liderët e partive politike kanë treguar më pak sensitivitet për përfaqësimin e rinisë, që është minore në kryesitë e partive, dhe nuk e tejkalon përfaqësimin e garantuar përmes kryetarëve të organizimeve rinore. Pjesëmarrja simbolike e rinisë në vendimarrjen partiake është një hendikep i madh edhe për politikë-bërjen për çështjet që janë në interes të tyre.

Përfaqësimi i grave në kryesitë e partive është më i lartë se i rinisë, dhe atë në LDK me 21%, LVV dhe AAK me 20%, PDK, 16.6%, dhe me 11% në NISMA. Ky përfaqësim, edhe pse i pamjaftueshëm, për dallim prej rinisë, jep hapësirë për ndikim më të rëndësishëm të grave në politikë-bërjen partiake për çështje gjinore. Në këtë aspekt, AAK ka bërë edhe një hap përpara, duke e paraparë në Statutin e ri kuotën prej 30% të përfaqësimit të grave në kryesitë e degëve dhe të partisë.

---

<sup>27</sup> *Ibid*, Neni 20

<sup>28</sup> *Ibid*, Neni 36

<sup>29</sup> Shih Listen e Kryesisë së AAK-së.

<sup>30</sup> Interviste me z. Jakup Krasniqin, Sekretar i Përgjithshëm i NISMES



## II. PROVIZIONET PROGRAMORE DHE PRAKTIKAT PARTIAKE NË KRIJIMIN E POLITIKAVE

### PËR GRATË DHE RININË

Ky seksion trajton provizionet programore dhe praktikat e krijimit të politikave për gratë dhe për rininë, me qëllim të ekzaminimit të ndikimit të organizimit dhe përfaqësimit të tyre në politikë-bërjen partiake.

***Partia Demokratike e Kosovës (PDK)***, në programin e saj partiak i ka kushtuar nga një seksion të veçantë rinisë dhe grave. Në seksionin për rininë të këtij programi, theksohet përkushtimi i PDK-së për arsimimin, punësimin dhe përfshirjen e rinisë në jetën politike e shoqërore të vendit, si dhe për ngritjen profesionale, punësimin dhe specializimin e saj në botën e jashtme.<sup>31</sup> Ndërkaq, në seksionin e programit të partisë kushtuar grave, theksohet angazhimi i PDK-së që për punë të njëjtë të ketë paga të njëjta pa dallim gjinie, dhe që do ta luftojë çdo formë të diskriminimit të gruas në këtë, dhe në aspekte të tjera, si dhe përkushtimi për t'i luftuar të gjitha format e tregtisë me gra dhe të prostitucionit.<sup>32</sup> Në aspektin e formulimit të politikave në këto fusha, programi zgjedhor i PDK-së i ka kushtuar nga një sub-seksion të plotë rinisë dhe grave, në të cilët janë të parapara edhe politikat konkrete për zhvillimin dhe fuqizimin e tyre<sup>33</sup>.

Mirëpo, në praktikë, PDK-ja, nuk e ka të krijuar ndonjë sistem të veçantë për formësimin e politikave për grate dhe rininë.<sup>34</sup> Për sa i përket politikave gjinore, bazuar në zyrtarë të lartë të kësaj partie, një pjesë e iniciativave vijnë nga gratë e PDK-së, por pjesa më e madhe e tyre ka ardhur nga Bashkimi Evropian, dhe nga organizatat e tjera ndërkombëtare, si dhe nga OJQ-të lokale dhe ndërkombëtare<sup>35</sup>. Po ashtu, këto politika në Kosovë kanë marrë karakter përtej-partiak, për shkak të Grupit të Grave në Kuvendin e Kosovës, të cilat kanë marrë një rol shumë të rëndësishëm në këtë fushë<sup>36</sup>.

---

<sup>31</sup> Programi i PDK, Seksioni 'Rinia.'

<sup>32</sup> *Ibid.*, Seksioni 'Emancipimi dhe të drejtat e gruas.'

<sup>33</sup> Shih programin zgjedhor të PDK-së "Misioni i Ri", [http://www.hashim-thaci.com/files/pages\\_files/14-05-30-07-36-00PROGRAMI\\_FINAL.pdf](http://www.hashim-thaci.com/files/pages_files/14-05-30-07-36-00PROGRAMI_FINAL.pdf)

<sup>34</sup> Interviste me z. Zenun Pajaziti, Anëtar i Kryesisë së PDK-së, mars 2015.

<sup>35</sup> *Ibid.*

<sup>36</sup> *Ibid.*

Për dallim nga çështjet gjinore, iniciativat që kanë të bëjnë me formësimin e politikave të PDK-së për rininë, kanë ardhur drejtëpërdrejtë nga përfaqësuesit e rinisë së partisë. Mirëpo, duke patur parasysh faktin që PDK është parti qeverisëse për 8 vite me radhë, politikat në këtë fushë janë gjeneruar në dikasteret përkatëse të Qeverisë së Kosovës që kanë qenë të udhëhequra prej saj. Po ashtu, për sa i përket vendim-marrjes dhe krijimit të politikave, në praktikë rinia e PDK-së ka patur një ndikim më të ndjeshëm se gratë. Drejtues të rinisë brenda partisë kanë arritur të marrin edhe poste ministrore në Qeverinë e Kosovës, ndërkaq, ndikimi i grave ka qenë më i limituar<sup>37</sup>.

***Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)***, në programin e vet, gjejësisht në seksionin ‘Vizioni human për shoqërinë’ shpreh angazhimin e vet për “barazi të plotë gjinore”, mirëpo nuk ka politikë të detajuar se si do të arrihet ky qëllim. Edhe pse rinia cilësohet si “pasuria më e madhe e Kosovës”, dhe ‘burim kryesor i zhvillimit ekonomik dhe potenciali kryesor për ndërtimin e shtetit demokratik e të qëndrueshëm’, përpos përkushtimit për arësim cilësor<sup>38</sup>, nuk parashihet asnjë politikë për këtë kategori shoqërore, përpos hapjes dhe përfshirjes së saj brenda partisë<sup>39</sup>. Një seksion i programit qeverisës të LDK-së i është përkushtuar rinisë,<sup>40</sup> ndërkaq, për sa i përket grave, programi nuk e ka ndonjë seksion të veçantë, dhe politika ndaj fuqizimit të tyre trajtohet vetëm me një paragraf në seksionin e zhvillimit ekonomik dhe të punësimit.<sup>41</sup>

Mirëpo, në praktikën e politikë-bërjes së LDK-së, bazuar në zyrtarë të lartë të kësaj partie, gratë dhe të rinjtë janë të përfshirë në sektorë të ndryshëm të Këshillit të Ekspertëve të LDK-së, dhe FGLDK dhe FRLDK konsultohen gjatë formulimit të programit partiak për zgjedhje<sup>42</sup>. Mirëpo, ashtu siç edhe mund të shihet nga faktet e sipërpërmendura, përfaqësimi i grave në organet vendim-marrëse të LDK-së nuk është përkthyer në politika konkrete partiake për forcimin e pozitës së tyre dhe për trajtimin e problemeve gjinore.

Megjithatë, në bazë të zyrtarëve të lartë të LDK-së, ky deficit i politikave për gratë është duke u kompenzuar nga Grupi i Grave Deputete në Kuvendin e Kosovës, që prin me iniciativat e politikave në këtë fushë në krahasim me partitë dhe institucionet e tjera qeveritare.<sup>43</sup>

***Lëvizja Vetëvendosje! (LVV)***, për dallim prej partive të tjera, në programin e vet partiak nuk ka seksione të veçanta për rininë dhe për gratë, dhe në politikat e veta programore nuk i kushton

---

<sup>37</sup> *Ibid.*

<sup>38</sup> Programi i LDK-së, seksioni “Qeverisje në shërbim të qytetarëve”

<sup>39</sup> *Ibid.*, seksioni “ Reformimi dhe modernizimi i partisë”

<sup>40</sup> <http://www.ldk-ks.eu/public/uploads/pdf/tresh-1401819799.pdf>

<sup>41</sup> *Ibid.*

<sup>42</sup> Intervistë me nënkryetaren e LDK-së, znj. Teuta Sahatqia, mars, 2015

<sup>43</sup> *Ibid.*

vëmendje këtyre çështjeve<sup>44</sup>. Në praktikë, për formulimin e çështjeve gjinore merret Sekretariati i Gruas Aktiviste. Ky Sekretariat, mes të tjerash bën edhe monitorimin e përfshirjes së grave në LVV, e cila tani ka arritur në 23%. Në bazë të zyrtarëve të kësaj partie, mungesa e organizimeve të veçanta për rininë dhe gratë është pasojë e antarësisë relativisht të re për nga mosha, dhe i angazhimit për ndarje të plotë të përgjegjësisë me burrat, që shpjegohet edhe me zgjedhjen e 4 nga 5 grave direkt me votë në zgjedhjet e kaluara parlamentare<sup>45</sup>.

**Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)**, në programin e vet partiak nuk ka ndonjë seksion të veçantë për rininë dhe gratë. Në programin e vet zgjedhor, “Drejtimi i Ri”, AAK e ka trajtuar rininë në një seksion të përbashkët me sportin dhe kulturën, ndërkaq, për sa i përket fuqizimit të grave, nuk parashihet pothuaj asgjë.<sup>46</sup>

Megjithatë, në bazë të zyrtarëve të lartë të AAK-së,<sup>47</sup> brenda partisë, përpos kuotave të përfaqësimit për gratë dhe rininë, është ndërtuar edhe kultura e komunikimit që nënkupton konsultimet, para marrjes së çfarëdo vendimi, me përfaqësuesit e Aleancës së Gruas dhe të Aleancës së Rinisë. Megjithatë, konsultimet brendapartiake nuk kanë rezultuar edhe në politika konkrete për gratë, si në aspektin programor të AAK-së, ashtu edhe në atë të programit zgjedhor.

**Nisma për Kosovën (NISMA)**, si parti e re e krijuar në prag të zgjedhjeve të kaluara të përgjithshme, ka prezentuar një program zgjedhor të shkurtër që probematikën e rinisë dhe atë të grave nuk e trajton fare. Në bazë të zyrtarëve të saj të lartë<sup>48</sup>, brenda NISMA-s është duke u ndërtuar kultura e diskutimit paraprak, me forumet e grave dhe të rinisë, për çështjet e tyre, mirëpo edhe në këtë parti ky diskutim nuk ka rezultuar në politikë-bërje partiake që i trajton çështjet që janë në interes të këtyre dy kategorive shoqërore.

**Konkuldím:** Bazuar në rezultatet e ekzaminimit të mësipërm, mund të konkludojmë që partitë politike të Kosovës nuk kanë sistem të ndërtuar të politikë-bërjes partiake për rininë dhe gratë, megjithë faktin që këto thirren në kulturën e konsultimeve brendapartiake. Po ashtu, rinia dhe gratë janë trajtuar fare pak, si në programet partiake, ashtu edhe në ato zgjedhoret. Megjithatë, PDK-ja qëndron më mirë për sa i përket formulimit programor për gratë dhe rininë, LDK-ja dhe AAK-ja i kushtojnë kujdes programatik vetëm rinisë, ndërkaq, LVV dhe NISMA këto nuk i trajtojnë fare.

---

<sup>44</sup> Shih parimet dhe prioritetet programore të LVV, [http://www.vetevendosje.org/wp-content/uploads/2013/09/programi\\_i\\_shkurte.pdf](http://www.vetevendosje.org/wp-content/uploads/2013/09/programi_i_shkurte.pdf)

<sup>45</sup> Interviste me z. Bojken Abazi, Sekretar per Marrredhenie me Jashte i LVV, Mars 2015

<sup>46</sup> Shih programin zgjedhor të AAK-së “Drejtimi i Ri”: <http://www.drejtimiri.com/fo/Broshura.pdf>

<sup>47</sup> Intervistë me z. Ardian Gjini, Nënkrjetar i AAK, mars, 2015.

<sup>48</sup> Intervistë me z. Jakup Krasniqi, Kryetar i Këshillit të Përgjithshëm të NISMA, mars 2015.

Këto fakte na çojnë në përfundimin që përfaqësimi, dhe posaçërisht ai i grave, në leadershipin e partive politike, nuk është përkthyer proporcionalisht edhe në politikë-bërje. Ky fakt e vë në pah shpërputhjen e përfaqësimit me kapacitetin e politikë-bërjes brenda partive politike, sidomos për çështjet gjinore.

### III. PROVIZIONET PROGRAMORE DHE PRAKTIKAT PARTIAKE NË KRIJIMIN E POLITIKAVE PËR KOMUNITETET ETNIKE

Ky seksion trajton provizionet programore dhe praktikat e krijimit të politikave për komunitetet etnike, me qëllim të ekzaminimit të politikë-bërjes partiake në këtë fushë, në mungesë të anëtarësisë nga ky segment i shoqërisë.

Në ***Partinë Demokratike e Kosovës (PDK)***, komunitetet etnike nuk kanë rol të drejtëpërdrejtë në vendimarrjen dhe krijimin e politikave në parti, për shkak të mos-prezencës së tyre në antarësinë e saj<sup>49</sup>. Megjithatë, PDK në aspektin programor<sup>50</sup>, por edhe në programin zgjedhor<sup>51</sup>, shpreh përkushtimin ndaj lirive dhe të drejtave të komuniteteve etnike, por jo edhe në gjenerimin e politikave konkrete nga partia. Krijimi i politikave konkrete nga ana e PDK-së në këtë fushë është bërë me çasje reaktive, gjegjësisht gjatë qeverisjes në bashkëpunim me partnerët qeveritarë të komuniteteve etnike, në të cilin rast rol kyç kanë patur edhe partnerët ndërkombëtarë.<sup>52</sup>

**Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)**, përballet, po ashtu, me mungesën e antarësisë nga komunitetet etnike. Në bazë të LDK-së, korniza kushtetuese dhe ligjore e Kosovës ka ndikuar që integrimi i komuniteteve etnike të bëhet përmes partive etnike, dhe këto rrethana kanë çuar në krijimin e një situatë në të cilën pjesëtarët e komuniteteve nuk kanë kurfarë arsye dhe kurfarë interesi për të qenë pjesë e partive me shumicë shqiptare. Kësisoj, raporti në mes të partive me shumicë shqiptare dhe të atyre të komuniteteve etnike është “jo me ne, por afër nesh”<sup>53</sup>. Në programin e vet, LDK-ja e shpreh përkushtimin për të drejtat dhe liritë e komuniteteve, duke i vënë ato së bashku me

---

<sup>49</sup> Intervistë me anëtarin e Kryesisë së PDK-së, z. Zenun Pajaziti, mars 2015.

<sup>50</sup> Shih: “Toleranca dhe mirëkuptimi ndëretnik”, Programi i PDK-së.

<sup>51</sup> Shih programin zgjedhor të PDK-së “Misioni i Ri”, [http://www.hashim-thaci.com/files/pages\\_files/14-05-30-07-36-00PROGRAMI\\_FINAL.pdf](http://www.hashim-thaci.com/files/pages_files/14-05-30-07-36-00PROGRAMI_FINAL.pdf)

<sup>52</sup> Intervistë me anëtarin e Kryesisë së PDK-së, z. Zenun Pajaziti, mars 2015.

<sup>53</sup> Intervistë me Nënkryetaren e LDK-së, z. Teuta Sahatqia, mars 2015.

grupet e tjera të cenuara të shoqërisë. Po ashtu, në programin e vet zgjedhor, LDK-ja nuk e trajton fare këtë fushë të politikë-bërjes.

**Lëvizja Vetëvendosje! (LVV)**, në aspektin programor angazhohet për të drejtat e komuniteteve etnike, mirëpo ato i emëron si të drejta të “pakicave”. LVV konsideron se “Serbët e Kosovës, sikur të gjitha pakicat tjera, duhet t’i gëzojnë të gjitha të drejtat njerëzore, qytetare, dhe të drejtat e pakicave<sup>54</sup>”, dhe shpreh angazhimin e vet, “për autonominë maksimale kulturore të këtyre pakicave”<sup>55</sup>, mirëpo, në anën tjetër, është kundër decentralizimit në baza etnike<sup>56</sup>. Në aspektin praktik, LVV mëton se ka marrëdhënie të mira me të gjitha komunitetet, përpos një distance më të madhe me komunitetin turk, pjesëtarët e të cilit, në bazë të zyrtarëve të lartë të kësaj partie, rrinë më larg, pasi janë më të afërt me PDK-në. Për sa i përket politikë-bërjes për komunitete, LVV angazhohet për dialogun me serbët e Kosovës<sup>57</sup>. Megjithatë, brenda LVV-së nuk ka mekanizëm i cili merret me politikë-bërjen për komunitete.

**Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)**, konsideron që ka njohje të mirë për komunitetet etnike, për shkak të integritetit në grupin e saj parlamentar të Iniciativës së Re Demokratike të Kosovës (IRDK), gjegjësisht partisë së egjiptianëve dhe të ashkalinjëve të Kosovës, si dhe të pjesëmarrjes në Komisionin Parlamentar për Komunitete që ka ndihmuar në qartësimin e interesave të tyre<sup>58</sup>. Mirëpo, si në aspektin programor, ashtu edhe në atë qeverisës, AAK-ja nuk e thekson asnjë angazhim për sa i përket komuniteteve etnike<sup>59</sup>.

**NISMA**, si parti e re, nuk ka pjestarë të komuniteteve brenda partisë, dhe, po ashtu, në aspektin programor nuk parasheh ndonjë provizion që i kushtohet komuniteteve etnike.

**Konkludim:** Ekzaminimi i fakteve të mësipërme tregon se partitë politike të Kosovës nuk e kanë të zhvilluar ndonjë sistem të politikë-bërjes për komunitetet etnike, dhe, po ashtu, nuk kanë asnjë sektor partiak që merret me këto çështje. Politikë-bërja në këtë fushë është sporadike dhe reaktive, që është më tepër përgjigje ndaj kërkesave të përfaqësuesve politik të komuniteteve etnike në qeveri dhe në parlament, dhe ndaj presionit të bashkësisë ndërkombëtare, sesa krijim i ideve dhe politikave pro-aktive për trajtimin e problemeve të tyre. Po ashtu, një hendikep i madh është mosekzistenca e ndonjë sektori politikë-bërës brendapartiak që do të merrej me komunitetet etnike. Në esencë,

---

<sup>54</sup> Pika 36, Prioritetet dhe parimet programore të LVV, [http://www.vetevendosje.org/wp-content/uploads/2013/09/programi\\_i\\_shkurte.pdf](http://www.vetevendosje.org/wp-content/uploads/2013/09/programi_i_shkurte.pdf)

<sup>55</sup> *Ibid.*, Pika 97.

<sup>56</sup> *Ibid.*, Seksioni “Decentralizimi”.

<sup>57</sup> Intervistë me z. Boiken Abazi, Sekretar për Marrëdhënie me Jashtë i LVV, mars, 2015.

<sup>58</sup> Intervistë me z. Ardian Gjini, Nënkyetar i AAK, mars, 2015.

<sup>59</sup> Shih, Programi i AAK (2013) dhe programin zgjedhor “Drejtimi i Ri”: <http://www.drejtimi.com/fo/Broshura.pdf>

politika ndaj komuniteteve etnike në Kosovë, nga partitë me shumicë shqiptare në praktikë trajtohet si një politikë qeveritare dhe legislative, dhe jo si ndonjë politikë brendapartiake.

### **KONKLuzionet dhe Rekomandimet**

Rezultatet e hulumtimit tregojnë që fuqizimi i grave dhe i rinisë në vendim-marjen e partive politike të Kosovës varet nga vullneti i kryetarëve të partive, që e kanë të drejtën statutores për ta propozuar përbërjen e plotë apo të pjesshme të kryesive të partive përkatëse.

Liderët e partive politike kanë treguar më pak sensitivitet për përfaqësimin e rinisë, që është minor në kryesitë e partive, dhe nuk e tejkalon përfaqësimin e garantuar përmes kryetarëve të organizimeve rinore, ndërkaq, Lëvizja Vetëvendosje nuk ka fare një organizim të tillë. Përfaqësimi i grave në kryesitë e partive politike të Kosovës është shumë më i lartë se ai i rinisë, dhe atë në LDK është 21%, në LVV dhe në AAK 20%, në PDK 16.6%, dhe 11% në NISMA. Ky përfaqësim, edhe pse i pamjaftueshëm, për dallim nga përfaqësimi i rinisë, të paktën ofron hapësirë për një ndikim më të rëndësishëm të grave në politikë-bërjen partiake për çështjet gjinore.

Mirëpo, partitë politike të Kosovës nuk kanë sistem të ndërtuar të politikë-bërjes partiake për rininë dhe gratë, megjithë faktin që kanë organizime brenda partiake për këto kategori shoqërore (përpos LVV, që e ka vetëm sekretariatën për çështje gjinore), dhe këto thirren në kulturën e konsultimeve brenda partiake. Si rezultat i këtyre rrethanave, rinia dhe gratë janë trajtuar në një mënyrë fare të vobektë, si në programet partiake, ashtu edhe në ato zgjedhoret. Fakt shqetësues është që përfaqësimi, dhe posaçërisht ai i grave, në lidhshpirtin e partive politike nuk është përkthyer proporcionalisht edhe në politikë-bërje, dhe kjo vë në pah disproporcionin e përfaqësimit vendim-marrës në raport me kapacitetin e politikë-bërjes brendapartiake. Një gjendje e tillë e vendim-marrjes dhe e politikë-bërjes partiake, vë në pikëpyetje edhe arsyeshmërinë e ekzistimit të organizimeve partiake të rinisë dhe të grave.

Për sa i përket komuniteteve etnike, politikë-bërja partiake është sporadike dhe reaktive, dhe kjo është më tepër përgjigje ndaj kërkesave të përfaqësuesve politikë të komuniteteve etnike në qeveri dhe në parlament, dhe e presionit të bashkësisë ndërkombëtare, në vend se krijim i ideve dhe i politikave pro-aktive për trajtimin e problemeve të tyre. Politika ndaj komuniteteve etnike në Kosovë, nga partitë me shumicë shqiptare, në praktikë trajtohet si politikë qeveritare dhe legislative, dhe jo si politikë brenda-partike.

### **REKOMANDIME:**

- Partitë politike të Kosovës duhet të ndërtojnë sisteme funksionale të politikë-bërjes, dhe ndërlihdjen e tyre me përfaqësimin vendim-marrës të grave dhe të rinisë brenda strukturave të tyre.
- Liderët e partive politike duhet të kenë parasysh rritjen e përfaqësimit të grave dhe, sidomos, të rinisë, në udhëheqësitë partiake.
- Partitë politike duhet të ndërtojnë brenda strukturave të tyre sektorë të politikë-bërjes për komunitetet etnike, me qëllim të ndërtimit të ekspertizës në këtë fushë, dhe të formulimit të politikave proaktive për adresimin e nevojave të tyre zhvillimore.